



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:285774

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644348

P.nr.201/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm Penal sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarit B. K nga V....., i akuzuar për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 dhe par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr7243/23 të datë 22.03.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 29.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi, të akuzuarit B. K. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare Izet Shala, të dëmtuarit M. Gj. me përfaqësuesen e tij ligjore dhe me mbrojtësin sipas autorizimit av. Arian Prebreza, me datë 30.04.2024 mori, publikisht shpalli si dhe përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. K., i biri i S..... dhe nëna N..., e gjinisë I..., i lindur me, në Zh..... KK V.....i, me vendbanim në F..... K..... Rr. “D.....” obj... kati 6 nr...., me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer fakultetin, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 17.12.2023 rreth orës 16.43 në F... K.... në udhëkryqin të “B.....”, i pandehuri B. K. nga pakujdesia e duke vepruar në kundërshtim me nenin 53 të ligjit për rregullat e trafikut rrugor, deri sa po drejtonte automjetin Damler Chrysler me targa në rrugën nga drejtimi i F.... K.... në drejtim të Prishtinës, kur kishte arritur tek kryqëzimi me semafor pran B..... M. duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes me shpejtësinë e kufizuar të lëvizjes, në pjesën e rrugës ku shpejtësia e lejuar e lëvizjes është e kufizuar në 40 km/h kishte zhvilluar shpejtësi prej 61 km/h, pastaj me atë shpejtësi të lëvizjes kishte hyrë në kryqëzimin e rrugëve në kohën kur semaforët nuk ishin duke punuar dhe ashtu duke mos qenë dhe i kujdesshëm për pjesëmarrësit tjerë në trafik në kalim e sipër në vendkalim të shënuar për këmbësorë me këndin e përpamë të djathtë të automjetit e kishte goditur këmbësorin M. Gj. i cili në atë moment ishte duke kaluar rrugën nëpër vendkalim të shënuar për këmbësorë, e si pasojë e aksidentit i dëmtuari pëson lëndime ku sipas ekspertizës mjeko ligjore këto dëmtime shoqërohen me pasoja të përhershme.

- Me këtë ka kryer veprën penale *Rrezikimi i trafikut publik* nga neni 370, paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 e lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42,44, 69, 70, 71, 72 dhe 370 par 8 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurin e:

GJYKON

- I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 3,000.00 (tremijë) Euro të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- III. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. I dëmtuari M. Gj. udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr7243/23 të datë 22.03.2024, ndaj të akuzuarit B. K. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale *Rrezikimi i trafikut publik* nga neni 370, paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe par.1 të Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-74.

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 29.04.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi të pandehurit B. K. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. Izet Shala dhe të dëmtuarit M. Gj. me mbrojtësin sipas autorizimit av. Arian Prebreza ku i akuzuari u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklaramentit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit B. K. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370, paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe par.1 të Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-74.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën nga pakujdesia, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, ndërsa rrethana rënduese nuk janë konstatuar nga Gjykata.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 42 dhe 44 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL

P.nr.201/24 datë 30.04.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimet të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.